



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVO  
MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE – MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE – MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE  
Administrata Tatimore e Kosovës – Poreska Administracija Kosova – Tax Administration of Kosovo

## **Të nderuar Tatimpagues**

Administrata Tatimore e Kosovës, njofton se nga **01 Prill 2010** të gjithë tatimpaguesit që kanë pikat e shitjes me para të gatshme janë të obliguar të pajisen me Pajisje Elektronike Fiskale.

Bizneset që do të përfshihen në fazën e parë dhe afatet për instalimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale, janë të përcaktuara si në vijim :

1. Bizneset që janë në kuadër të Njësisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, ( NJTM ) duhet të pajisen me Pajisje Elektronike Fiskale, më së largu deri me 15 Maj 2010 .
2. Bizneset që përfshihen në kuadër të bizneseve të mesme ( NJTM në Regjione ) duhet të pajisen me Pajisje Elektronike Fiskale më së largu deri me 31 Maj 2010 .
3. Bizneset me veprimtari a) Hoteliere dhe Restorante; b) Markete – Tregtia me shumicë dhe pakicë; c) Barnatore që veprojnë në kuadër të Regjionit Prishtina 1, duhet të pajisen me Pajisje Elektronike Fiskale më së largu deri me 30 Qershor 2010 .
4. Bizneset me veprimtari a) Hoteliere dhe Restorante; b) Markete – Tregtia me shumicë dhe pakicë; c) Barnatore që veprojnë në Regjionet : Prishtina 2; Prizren; Gjakovë; Pejë; Mitrovicë; Gjilan; Ferizaj, duhet të pajisen me Pajisje Elektronike Fiskale më së largu deri me 30 Korrik 2010 .

**Administrata Tatimore e Kosovës**